

INFORMATA MBI GRANTIN

| | |
|--|---|
| Instrumenti: | Grant Institucional |
| Subjekti zbatues: | Shoqata e personave me aftësi të kufizuara-Handikos Ferizaj |
| Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website): | Rruga "Zenun Beqa" Ferizaj handikosferizaj@gmail.com +383 (49) 945 102 www.handikosferizaj.org |
| Kohëzgjatja e grantit: | Data e fillimit: 01/03/2026 Data e përfundimit: 31/08/2028 |
| Buxheti i përgjithshëm i organizatës (EUR): | EUR 290,995.60 |
| Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR): | EUR 98,855.00 |
| Grupet e synuara: | <ul style="list-style-type: none">• Personat me aftësi të kufizuara• Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara• Institucionet lokale• Komuniteti i gjerë |
| Shtrirja gjeografike: | Ferizaj |
| Përmbledhje e grantit: | Ky grant synon forcimin e kapaciteteve organizative, menaxheriale dhe profesionale të Handikos Ferizaj, me qëllim rritjen e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Ferizajt dhe zonat përreth. Strategjia fokusohet në zhvillimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e menaxhimit dhe qeverisjes së brendshme, digjitalizimin e proceseve dhe ndërtimin e partneriteteve afatgjata me sektorin publik dhe privat. Qëllimi i përgjithshëm është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve përmes forcimit të |

Bashkëfinancuar nga:



| | |
|--|--|
| | <p>kapaciteteve të organizatës si një akter referent në nivel lokal dhe rajonal.</p> <p>Qëllimet specifike përfshijnë: fuqizimin profesional të stafit, rritjen e transparencës dhe efikasitetit përmes procedurave standarde, krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm financiarë dhe thellimin e bashkëpunimit me komunitetin dhe donatorët. Strategjia mbështet programet kryesore të organizatës: ndërhyrjen e hershme, shërbimet me bazë në komunitet, avokimin dhe vetë-përfaqësimin, si dhe pajisjet asistive. Brenda 30 muajve, Handikos Ferizaj synon të funksionojë me strukturë më të konsoliduar, staf më të përgatitur dhe sistem menaxhimi më efikas, duke garantuar shërbime cilësore, të qëndrueshme dhe me ndikim afatgjatë për personat me aftësi të kufizuara.</p> |
|--|--|